



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo Agency of Statistics

HARTA RRUGORE E ASK-së PËR VITIN 2015

Dhjetor 2014
Prishtinë

PARATHËNIE

Ky dokument përmban planin operativ të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) dhe është i bazuar në Planin Vjetor të Statistikave Zyrtare për vitin 2015 të ASK-së, si dhe në Programin e Statistikave Zyrtare 2013-2017, i cili është aprovuar nga Qeveria e Kosovës dhe është vendosur në Gazetën Zyrtare.

Në vitin 2015, ASK-ja do të jetë e përqendruar në: zbatimin e Programit Vjetor të Statistikave Zyrtare 2015; zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2013-2017; avancimin e sistemit të planifikimit dhe të monitorimit përmes Sistemit të SIPK-ut; zbatimin e ligjeve dhe të rregulloreve ekzistuese dhe ato që priten të aprovohen; ngritjen e kapaciteteve në ASK, posaçërisht në statistikat ekonomike dhe në mbledhjen e të dhënave.

Në këtë dokument janë paraqitur aktivitetet më të rëndësishme të ASK-së, që janë të bazuara në planet dhe detyrat e rregullta, të paraqitura në formë të proceseve rrugore të integruara. Përderisa, planet më të detajuara* ekzistojnë në dokumentet e brendshme të departamenteve përkatëse të ASK-së.

Në pjesën e parë të vitit 2015, sipas Ligjit për Statistikat Zyrtare, ASK-ja do ta përgatisë një Raport Vjetor, përmes të cilit vlerësohet (matet) performanca e departamenteve, respektivisht arritjeve në ASK dhe në Sistemin Statistikor të Kosovës. Dallimet eventuale, ndërmjet asaj që është planifikuar dhe asaj që realizuar, barten si pjesë e planit për vitin vijues. Sipas Ligjit të Statistikave Zyrtare të Kosovës, Raporti dërgohet në Qeveri dhe në Kuvendin e Kosovës për miratim.

* Planet e detajuara nënkuptojnë dokumentet që i kanë departamentet përkatëse, të cilat cilësohen si “fletë punuese”.

PËRMBAJTJE

	Faqe
1. ORGANIZIMI I ASK-së.....	4
1.1 Aktivitete të rëndësishme që priten të finalizohen në 2015.....	5
2. KËSHILLI STATISTIKOR	5
3. ZHVILLIMI I DEPARTAMENTEVE SIPAS PLANIT VJETOR 2015	6
3.1. Departamenti i Administratës	6
3.2. Departamenti për Politika, Planifikim, Koordinim dhe Komunikim	7
3.3. Departamenti i Regjistrimeve dhe Anketimeve	7
3.4. Departamenti i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare	8
3.5. Departamenti i Statistikave Sociale	12
3.6. Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit.....	14
3.7 Departamenti i Metodologjisë dhe Teknologjisë Informative	15
4. FUSHAT E MBËSHTETURA NGA DONATORËT	17
5. SFIDAT	18
6. SHPËRNDARJA E TË DHËNAVE & QASJA.....	19
7. BUXHETI	23
Aneksi 1 - Organogrami i ASK	25

1. ORGANIZIMI I ASK-së

Procesi i ngritjes së kapaciteteve profesionale të ASK-së, është një proces dinamik, gjithnjë në funksion të rritjes së performancës dhe përmbushjes së misionit të saj, respektivisht plotësimit të nevojave të përdoruesve me të dhëna statistikore të sakta, të besueshme, në kohë dhe të krahasueshme ndërkombëtarisht. Përpjekjet për implementimin e plotë të legjislacionit për prodhimin e statistikave zyrtare kanë vazhduar dhe do të vazhdojnë edhe gjatë vitit 2015, duke përfshirë edhe rritjen e burimeve njerëzore.

Sipas Ligjit për Statistikat Zyrtare (pritet që institucionet e Kosovës gjatë vitit 2015 t'i aprovojnë plotësim-ndryshimet e këtij Ligji) dhe Programit të Statistikave Zyrtare 2013-2017, para ASK-së shtrohen detyra dhe përgjegjësi të mëdha në ngritjen edhe zhvillimin e statistikave zyrtare në nivel vendi, në harmoni me rekomandimet dhe standardet ndërkombëtare statistikore.

Prandaj, si rezultat i Ligjit të lartëcekur, ASK-ja ka përgjegjësi të përgjithshme në prodhimin e statistikave zyrtare dhe për çështje të tjera, që parashihen me Ligj dhe me aktet nënligjore.

Si rrjedhojë e kësaj, gjatë vitit 2015, ASK-ja planifikon:

- Përcaktimin dhe zhvillimin e metodologjisë statistikore, klasifikimin dhe përdorimin e standardeve për prodhimin e statistikave zyrtare. Për të gjitha publikimet e dala nga ASK-ja do të zbatohen të gjitha metodologjitë dhe standardet e statistikave evropiane.
- Ta paraqesë për miratim, përmes Kryeministrit, Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës, Raportin Vjetor 2014 mbi zbatimin e planit, programit dhe shfrytëzimin e mjeteve buxhetore. Raporti vjetor i miratuar do të publikohet.
- Bashkëpunimi me organizatat vendore dhe ndërkombëtare kompetente për statistikave zyrtare do të fuqizohet, me qëllim që të mundësohet krahasimi i statistikave zyrtare të Kosovës me statistikave të prodhuara në sisteme të tjera statistikore. Do të rritet përfitimi nga bashkëpunimi statistikor me organizatat ndërkombëtare me pjesëmarrjen e stafit të ASK-së në takime, punëtori dhe seminare, në fusha të ndryshme statistikore, si dhe me ekspertët ndërkombëtarë në ASK.
- T'i publikojë të dhënat preliminare dhe ato finale nga Projekti i Regjistrimit të Bujqësisë

- Të vazhdojë me organizimin e takimeve të Këshillit Statistikor, etj.

1.1 Aktivitete të rëndësishme që priten të finalizohen në 2015

- Rritja e kapaciteteve në ASK (njerëzore dhe infrastrukurore) dhe fuqizimi i statistikave ekonomike.
- Prodhimi i statistikave sipas standardeve evropiane dhe botërore dhe zgjerimi i volumit të tyre. Pjesëmarrja në takime ndërkombëtare, implementimi i metodologjisë statistikore evropiane.
- Avancimin e zbatimit të Kornizës së Vlerësimit të Performancës.
- Realizimi i Projektit të Regjistrimit të Bujqësisë - projekt që do të realizohet në kuadër të IPA 2012 dhe IPA 2013 me pjesëmarrje të donatorëve të tjerë dhe participim të Qeverisë së Kosovës.
- Sigurimi/rritja i/e buxhetit të nevojshëm nga buxheti i Kosovës, me theks të veçantë në kategorinë Paga dhe Mëditje.
- Plotësim-Ndryshimi i Ligjit të Statistikave Zyrtare dhe Ligjit për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në komunat e Kosovës, që nuk kanë marrë pjesë në Regjistrimin e Popullsisë 2011.

2. KËSHILLI STATISTIKOR

Këshilli përbëhet nga dymbëdhjetë (12) anëtarë dhe Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së, që përfaqësojnë ministritë kyçe, Bankën Qendrore, Administratën Tatimore, universitetet, komunitetin e biznesit dhe shoqërinë civile, siç janë cekuar më poshtë:

- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,
- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale,
- Ministria e Shëndetësisë,
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë,
- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë,
- Ministria e Financave,
- Banka Qendrore e Republikës së Kosovës,
- Universiteti i Prishtinës,
- Administrata Tatimore e Kosovës,
- Zyra e Planifikimit Strategjik pranë Zyrës së Kryeministrit,
- Aleanca Kosovare e Bizneseve,
- Instituti për Menaxhimin e Ndërmarrjeve dhe Inxhinieri (IMNI).

Këshilli Statistikor, ashtu siç ka vepruar deri më tash, do të jep rekomandime mbi përgatitjen dhe realizimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2013-2017, si dhe mbi zhvillimin dhe funksionimin e gjithëmbarshtëm të ASK-së, respektivisht Sistemit Statistikor të Kosovës.

Këshilli është themeluar me Vendim të Kryeministrit dhe do të funksionojë në mbështetje të Rregullores së miratuar, konform Ligjit për Statistika Zyrtare. Këshilli Statistikor ka dërguar Raportin I në ZKM, ndërkohë është në proces Raporti II dhe gjatë vitit tjetër do ta përgatisë Raportin Vjetor të radhës dhe do ta dërgojë në ZKM.

3. ZHVILLIMI I DEPARTAMENTEVE SIPAS PLANIT VJETOR 2015

Një ndër qëllimet e ASK-së është ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve profesionale sipas standardeve dhe metodologjive të kërkuara nga Eurostati. Ky zhvillim i departamenteve do të bëhet në pajtim me politikat e diseminimit për: evitimin e të gjitha gabimeve të mundshme në publikimet e ASK-së; zhvillimin e mëtejshëm të metodologjive dhe teknologjisë statistikore; zhvillimin e politikave të standardizimit dhe mbështetjen me ekspertë ndërkombëtarë për implementimin e këtyre standardeve.

ASK-ja, në kuadër të këtij zhvillimi, do të ofrojë ndihmë profesionale për interpretimin e saktë të të dhënave zyrtare statistikore.

Më poshtë janë dhënë zhvillimet e parapara sipas departamenteve për vitin 2015.

3.1. Departamenti i Administratës

Departamenti i Administratës është përgjegjës për ofrimin e shërbimeve administrative ditore në ASK, si: operacione financiare, kontabilitet, prokurim, rekrutime, gjegjësisht procedura, administrim i personelit (vijueshmëria në punë, largime, dosje personale, etj.), furnizime, logjistikë, etj. Shprehur me fjalë të tjera, përgatitja e pasqyrave financiare, raporteve mujore, gjashtëmujore, nëntëmujore dhe vjetore; shërbime të personelit, duke mbuluar mirëqenien, rekrutimin dhe menaxhimin e burimeve njerëzore; prokurimin dhe shërbimet për menaxhimin e kontratave (menaxhimi i aseteve, pronës dhe shërbimet e logjistikës). Në kuadër të Departamentit të Administratës, sipas Rregullores për Riorganizimin e ASK-së janë angazhuar një drejtor dhe 13 zyrtarë.

Një prej pikave kyçe do të jetë zbatimi i Planit të Punës 2015, si dhe respektimi i të gjitha procedurave, gjegjësisht legjislacionit në fuqi, në funksion të menaxhimit të aktiviteteve të lartëcekura.

3.2. Departamenti për Politika, Planifikim, Koordinim dhe Komunikim

Sipas Rregullores për Riorganizimin e ASK-së është krijuar departamenti i ri në ASK: Departamenti për Politika, Planifikim, Koordinim dhe Komunikim. Në këtë departament janë plotësuar tashmë disa pozita kyçe. Ky Departament është përgjegjës për planifikimin në ASK, për përmirësimin e bashkëpunimit (me institucionet vendore dhe ndërkombëtare), koordinimin (brenda ASK-së dhe Sistemit Statistikor të Kosovës), zhvillimin dhe zbatimin e politikave, si dhe monitorimin e prodhimit të statistikave zyrtare. Po ashtu, ky departament do të ketë rol qendror në monitorimin dhe implementimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2013-2017.

Departamenti i PPKK-së do të ofrojë këshilla për ASK-në dhe Sistemin më të gjerë Statistikor të Kosovës dhe për palët e tjera të interesuara sipas nevojës.

Ky departament duhet të paraqesë të dhëna të Kryeshëfi Ekzekutiv i ASK-së lidhur me performancën e departamenteve prodhuese dhe mbështetëse në ASK.

3.3. Departamenti i Regjistrimeve dhe Anketimeve

Departamenti i Regjistrimeve dhe Anketimeve do të jetë përgjegjës për zbatimin dhe organizimin e regjistrimeve dhe anketave sociale, ekonomike, bujqësore, si dhe mbledhjen dhe grumbullimin e të dhënave të tjera që kërkohen nga ASK-ja.

Ky departament ka divizionin e regjistrimit dhe divizionin e anketimeve.

DRA ka nën ombrellën e vet edhe shtatë (7) zyret rajonale të ASK-së. Departamenti i Regjistrimeve dhe Anketimeve do ta ketë rolin e menaxhimit dhe mbikëqyrjes së aktiviteteve operative të zyrave rajonale të ASK-së lidhur me mbledhjen e të dhënave në terren.

Departamenti i Regjistrimeve dhe Anketimeve për vitin 2015 planifikon që të marrë pjesë aktive në Projektin e Regjistrimi e Popullsisë në komunat veriore të Kosovës, të cilat nuk kanë marrë pjesë në Regjistrimin e Popullsisë 2011.

Do ta bëjë harmonizimin e metodave për grumbullimin e të dhënave për anketa, si dhe do ta bëjë monitorimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen e punëve në kuadër të anketave të nevojshme për Divizionin i regjistrimeve. Po ashtu, do të ofrojë bashkëpunim me departamentet e tjera në ASK dhe jashtë ASK-së. Ndërkohë, departamenti do të përgatisë raportet mbi ecurinë e aktiviteteve të parapara.

3.4. Departamenti i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare

Departamenti, në bazë të strukturës organizative, aktualisht përbëhet nga tri divizione: Divizioni i Llogarive Kombëtare, Divizioni i Statistikave të Çmimeve dhe Divizioni i Ndërmarrjeve dhe Statistikave të Tregtisë së Jashtme.

Në programin e vitit 2015, departamenti ka këto prioritete: shkurtimin e afatit të publikimit të Bruto Produktit Vendor (BPV) në baza tremujore, në të dy qasjet, me çmime aktuale dhe konstante; përmirësimi i metodologjises se përpilimit të Llogarive Kombëtare në baza vjetore, sipas ESA 2010 dhe SNA 2008; përmirësimi i cilësisë së regjistrit të bizneseve; fillimi i publikimeve të reja tremujore, si stasitkat tremujore të tregtisë me pakicë, përmirësimi i statistikave afatshkurta të ndërtimit; fillimi me Indeksën e harmonizuar të çmimeve të konsumit (HICP–eng); shkurtimi i afateve të publikimeve të statistikave tremujore, sipas strategjisë 2013-2017.

Pjesëmarrja me pilot projektet IPA 2012 (MB) me projektet e veçanta të kësaj fushe. Vazhdimi me Projektin e Binjakëzimit për mbështetje të statistikave të biznesit, Llogarive Kombëtare; vazhdimi i asistencës teknike nga SIDA; për statistikave të çmimeve dhe intensifikimi i asistencës teknike të FMN-së për Llogaritë Kombëtare dhe për Statistikat e Finacave Qeveritare, do të jenë mundësi e mirë për arritjen e objektivave tona.

Më poshtë është lista e publikimeve të pritura në Departamentin e Statistikave Ekonomike në vitin 2015.

Muaji i botimit	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Kor	Gus	Sht	Tet	Nën	Dhj
Statistikat e tregtisë së Jashtme	Dhj-14	Jan-15	Shk 2015	Mar 2015	Pri-15	Maj-15 & 2014 vj.	Qer 2015	Kor 2015	Gush 2015	Sht 2015	Tet 2015	Nën 2015
Indeksi i çmimeve të Konsumit	Dhj-14	Jan-15	Shk 2015	Mar 2015	Pri-15	Maj-15 & 2014 vj.	Qer 2015	Kor 2015	Gush 2015	Sht 2015	Tet 2015	Nën 2015
Statistikat e Hotelarisë			TM4 /2014			TM1 /2015			TM2 /2015			TM3 /2015
Indeksi i çmimit të importit			TM4 /2014			TM1 /2015			TM2 /2015			TM3 /2015
Bilanci i Energjisë në Kosovë			TM4 /2014			TM1 /2015			TM2 /2015			TM3 /2015
Indeksi i çmimeve të prodhimit			TM4 /2014			TM1 /2015			TM2 /2015			TM3 /2015
Rep.stat mbi ndërmarrjet në Kosovë		TM4 /2014			TM1 /2015			TM2 /2015			TM3 /2015	
Statistikat e Transportit		TM4 /2014			TM1 /2015			TM2 /2015			TM3 /2015	
Ilogarit Qeveritare						2014						
Bruto produkti vendor BVP-Qasja e Shpenzimeve											2014	
Rezultatet e Anketes Strukturore te ndërmarrjeve												2014
Bruto produkti vendor BVP-Qasja e Prodhimit											2014	
BVP tremujore-Qasja e shpenzimeve dhe prodhimit		TM2 /2014		TM3 /2014		TM4 /2014		TM1 /2015			TM2 /2015	
Indeksi i Kostose Ndërtimit			TM4 /2014			TM1 /2015			TM2 /2015			TM3 /2015
Statistikat tremujore per Industri			TM4 /2014			TM1 /2015			TM2 /2015			TM3 /2015
Statistikat tremujore per Tregti me pakice*				TM4 /2013			TM1 /2014		TM2 /2014			TM3 /2014

Vëreni se muaji i shkruar në kutinë e hijëzuar paraqet muajin/vitin e raportuar, përderisa muaji në krye të tabelës është muaji në të cilin publikimet priten të shpërndahen.

/* Publikimi i fundit është publikim i ri, i cili publikohet për herë të parë.

Gjatë vitit 2015 planifikohen të realizohen këto aktivitete, sa i përket statistikave makroekonomike.

Aktivitetet tjera

- a) Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve 2014:
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), prill-qershor 2015,
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, maj -shtator 2015,
 - Përgatitja e të dhënave përfundimtare për BPV, tetor 2015,
 - Publikimi i të dhënave, dhjetor 2015.
- b) Anketa për Azhurnimin e Regjistrimit Statistikor të Bizneseve 2015:
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), shtator-tetor 2015,
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, tetor -dhjetor 2015.
- c) Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve për Industri, TM4 /2014:
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), janar - shkurt 2015,
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, janar -mars 2015,
 - Publikimi i të dhënave, mars 2015.
- d) Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve për Industri, TM1 /2015:
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), prill-maj 2015,
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, prill - qershor 2015,
 - Publikimi i të dhënave, qershor 2015.
- e) Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve për Industri, TM2 /2015:
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), korrik - gusht 2015,
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, korrik – shtator 2015,
 - Publikimi i të dhënave, shtator 2015.
- f) Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve për Industri, TM3/2015:
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), tetor –nëntor 2015,
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, tetor - dhjetor 2015,
 - Publikimi i të dhënave, dhjetor 2015.
- g) Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve për Ndërtim, TM4 /2014:
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), janar - shkurt 2015,

- Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, janar -mars 2015.
- h) Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve për Ndërtim, TM1 /2015:
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), prill-maj 2015,
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, prill - qershor 2015.
- i) Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve për Ndërtim, TM2 /2015:
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), korrik - gusht 2015,
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, korrik – shtator 2015.
- j) Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve për Ndërtim, TM3/2015:
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), tetor –nëntor 2015,
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, tetor - dhjetor 2015.
- k) Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve për Tregti me Pakicë, TM4 /2014:
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), janar - mars 2015,
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, shkurt -mars 2015,
 - Publikimi i të dhënave, prill 2015.
- l) Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve për Tregti me Pakicë, TM1 /2015:
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), prill -maj 2015,
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, maj - qershor 2015,
 - Publikimi i të dhënave, korrik 2015.
- m) Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve për Tregti me Pakicë, TM2 /2015:
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), korrik - gusht 2015,
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, gusht – shtator 2015,
 - Publikimi i të dhënave, shtator 2015.
- n) Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve për Tregti me Pakicë, TM3/2015:
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), tetor –nëntor 2015,
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, nëntor -dhjetor 2015,
 - Publikimi i të dhënave, dhjetor 2015.
- o) Anketa për Çmimet e Kostos së Ndërtimit, TM4 /2014:
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), janar - shkurt 2015,
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, janar -mars 2015,
 - Publikimi i të dhënave, mars 2015.

- p) Anketa për Çmimet e Kostos së Ndërtimit, TM1 /2015:
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), prill-maj 2015,
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, prill - qershor 2015,
 - Publikimi i të dhënave, qershor 2015.
- q) Anketa për Çmimet e Kostos së Ndërtimit, TM2 /2015:
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), korrik - gusht 2015,
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, korrik – shtator 2015,
 - Publikimi i të dhënave, shtator 2015.
- r) Anketa për Çmimet e Kostos së Ndërtimit, TM3/2015:
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), tetor –nëntor 2015,
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, tetor - dhjetor 2015,
 - Publikimi i të dhënave, dhjetor 2015.
- s) Pilot Projektet e IPA 2012 (MB)* - Programi i bashkëpunimit statistikor me shumë përfitues IPA 2012:
- Pariteti i Fuqisë Blerëse,
 - Llogaritë Kombëtare,
 - Statistikat afatshkurtra të ndërmarrjeve,
 - Statistikat e Tregtisë së Jashtme për Mallra,
 - Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit,
 - Statistikat e Transportit,
 - Statistikat e Turizmit.

/* Dinamika e realizimit të pilot projekteve të IPA 2012 do të jetë sipas kontratës së nënshkruar. Ky projekt ka filluar me disa, në vitin 2014, të cilat përfundojnë gjatë vitit 2015, si dhe disa që do të fillojnë në vitin 2015 dhe do të përfundojnë në vitin 2015.

3.5. Departamenti i Statistikave Sociale

Departamenti i Statistikave Sociale (DSS), përbëhet nga dy divizione: Divizioni i Statistikave Sociale dhe Divizioni i Statistikave të Popullsisë dhe është përgjegjës për prodhimin e statistikave sociale dhe statistikave të popullsisë.

Lista e publikimeve të pritura në Departamentin e Statistikave Sociale në vitin 2015

Muaji i botimit	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Kor	Gus	Sht	Tet	Nën	Dhj
Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare					2014						
Anketa e Fuqisë Punëtore				2014							
Statistikat e Jurisprudencës për personat madhor					2014						
Statistikat e Arsimit-Përmbledhje e të gjitha niveleve										2014/2015	
Statistikat e Arsimit për çerdhe dhe parashkollor					2014/2015						
Statistikat e Arsimit fillor dhe të mesëm të ulët						2014/2015					
Statistikat për Arsimin e mesëm të lartë							2014/2015				
Statistikat e Varfërisë								2013			
Statistikat e Jurisprudencës për persona të mitur								2014			
Statistikat e Kulturës									2014		
Statistikat e Mirëqenies Sociale	2014			TM1/2015			TM2/2015			TM3/2015	
Statistikat e Shëndetësisë										2014	
Statistikat e Lindjeve					2014						
Statistikat e Vdekjeve						2014					
Statistikat e Kurorëzimeve						2014					
Statistikat e Shkurorëzimeve						2014					
Gratë dhe Burrat në Kosovë				2012/2013							

Vëreni se muaji i shkruar në kutinë e hijezuar paraqet muajin e raportuar të botimit, përderisa muaji në krye të tabelës është muaji në të cilin publikimet priten të shpërndahen.

Aktivitetet e tjera

- Publikimi i botimit “Statistikat e Varfërisë 2013”, shtator 2015. Ky aktivitet është rezultat i bashkëpunimit me Bankën Botërore.
- Zhvillimi i Pilot Anketës “Të ardhurat dhe kushtet e jetesës” SILC - projekt i mbështetur nga IPA 2012.
- Digjitalizimi i të dhënave të Statistikave të Arsimit në kuadër të MASHT-it.
- Digjitalizimi i të dhënave të Statistikave Vitale – vazhdon bashkëpunimi me Agjencinë e Regjistrimit Civil, në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), si udhëheqës të Projektit për Digjitalizimin e Regjistrimit të Gjendjes Civile.

3.6. Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit

Departamenti do të jetë përgjegjës për mbledhjen, analizimin dhe publikimin e statistikave zyrtare të besueshme dhe me kohë për bujqësi, pylltari, statistika agro-monetare dhe të mjedisit, si dhe standardizimi i prodhimit të këtyre statistikave me BE-n.

Bazuar në strukturën e re të organizimit të ASK-së, Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit ka dy divizione, në kuadër të saj: Divizioni i Statistikave të Bujqësisë dhe Divizioni i Statistikave të Mjedisit. Departamenti i Bujqësisë dhe Mjedisit do të vazhdojë nxjerrjen e botimeve të rregullta, të parapara në kalendarin e botimeve 2015. Prioritet i departamentit për vitin 2015 do të jetë Regjistrimi i Bujqësisë, harmonizimi me standarde dhe me metodologjitë e Eurostatit, përmirësimi i kualitetit të këtyre statistikave dhe shkurtimi i kohës së prodhimit të statistikave.

Më poshtë është lista e publikimeve të pritura në Departamentin e Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit në vitin 2015

Muaji i botimit	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Kor	Gus	Sht	Tet	Nën	Dhj
Indeksi i Çmimeve të Prodhimeve dhe Çmimet në Bujqësi	2010-2014 TM4/ 2014			TM1/ 2015			TM2/ 2015			TM3/ 2015	
Indeksi i Çmimeve të Inputeve dhe Çmimet në Bujqësi	2010-2014 & TM4/ 2014			TM1/ 2015			TM1/ 2015			TM3/ 2015	
Anketa e Mbeturinave Industriale											2014
Anketa e Mbeturinave Komunale											2014
Llogaritjet Ekonomike në Bujqësi 2014											2014

Vëreni se muaji i shkruar në kutinë e hijezuar paraqet muajin e raportuar, përderisa muaji në krye të tabelës paraqet muajin në të cilin publikimet priten të shpërndahen.

Aktivitet e tjera në Departamentin e Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit

1. Realizimi i pilot projekteve në kuader të IPA 2012:
 - a. Statistikat vjetore të kulturave bujqësore,
 - b. Statistikat e prodhimit të blegtorale (statistikat mujore dhe vjetore mbi therjet e kafshëve, statistikat mujore dhe vjetore mbi prodhimin e qumshtit),
 - c. Statistikat Agromonetare (llogaritjet ekonomike në bujqësi dhe çmimet dhe indeksi i çmimeve në bujqësi).
2. Realizimi dhe ridizajnimi i Anketës së Bujqësisë 2015.
3. Publikimi i botimit “Llogaritë Ekonomike në Bujqësi 2014”. Ky publikim mund të realizohet në rast se do të ekzistojë mbështetja teknike nga SIDA/SCB.

Regjistrimi i Bujqësisë

Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit, si prioritet në vitin 2015, ka shpalljen e rezultateve preliminare në shkurt dhe atyre finale në shtator të vitit 2015.

Aktivitetet për Projektin e Regjistrimit të Bujqësisë në vitin 2015:

- Rishikimi i buxhetit të RB-së,
- Vendosja e aplikacionit për futjen e shënimeve të RB-së sipas propozimit dhe sipas rregullave të editimit etj.,
- Futja e shënimeve të Regjistrimit të Bujqësisë në bazën e shënimeve,
- Pastrimi i të dhënave të Regjistrimit të Bujqësisë nga gabimet eventuale,
- Përgatitja dhe publikimi i rezultateve preleminare të RB-së,
- Analiza dhe publikimi i rezultateve finale të RB-së,
- Publikimi i rezultateve të PES-it,
- Publikimi i të gjitha rezultateve nga të e dhënat e RB.

3.7 Departamenti i Metodologjisë dhe Teknologjisë Informative

Departamenti i Metodologjisë dhe TI-së ka dy divizione, sipas planit të riorganizimit: Divizioni i Metodologjisë dhe Diseminimit dhe Divizioni i Teknologjisë Informative dhe Infrastrukturës. Divizioni i TI-së do të vazhdojë t'i mbështesë departamentet prodhuese, duke përmirësuar sistemin e brendshëm të TI-së (Intranetin), në mënyrë që ta lehtësojë shkëmbimin e informatave statistikore, jo vetëm brenda ASK-së, por edhe me institucionet e tjera qeveritare.

Do ta rrisë bashkëpunimin me ASHI-në, me qellim që të përfitojmë nga projektet qeveritare përmes e-Qeverisjes, si dhe do të vazhdojë bashkëpunimin me institucionet e tjera, si: MPB, MSH, MASHT, si dhe me institucione të tjera, me qellim të përmirësimit të sistemit për shkëmbimin e të dhënave statistikore.

Për ta rritur efikasitetin dhe funksionalitetin, si dhe zvogëlimin e shpenzimeve të TI-së, ASK-ja gjatë vitit 2015 do ta përfundojë virtualizimin e të gjithë serverëve.

Krijimi i një baze të shënimeve unike dhe migrimi i të gjitha shënimeve në platformën e SQL, mbetet prioritet edhe për vitin 2015.

Në vazhdimësi, do të mbështeten departamentet e statistikave prodhuese me ofrimin e të dhënave hapësinore, si dhe në krijimin e hartave tematike, me theks të veçantë për Projektin e Regjistrimit të Bujqësisë përmes teknologjisë së GIS-it.

Sipas planit të aktiviteteve të TI-së 2013-2017, për vitin 2015 do të jenë edhe disa aktivitete të tjera, të cilat pritet të realizohen në bashkëpunim me donatorët (IPA 2012 - Projekti i Binjakëzimit me statistikat daneze dhe statistikat suedeze, të mbështetura nga SIDA suedeze):

- Dizajnimi dhe zhvillimi i ueb faqes së re të ASK-së, në platformën ASP.NET;
- Zhvillimi i bazës së të dhënave të agreguara për ueb-shpërndarje (Implementimi i PC-Axis);
- Implementimi dhe integrimi i SharePoint në ASK;
- Zhvillimi i mëtejme i Sistemit të Përfshirjes së Kohës (SIPK).

Ndërsa, si aktivitete shtesë, për Divizionin e Metodologjisë dhe Diseminimit për vitin 2015 planifikohen këto aktivitete:

- Vjetari Statistikor i ASK-së, i cili planifikohet të përgatitet gjatë pjesës së parë të vitit 2015;
- Nxjerrja e mostrave për Anketën e Buxhetit Familjar;
- Nxjerrja e mostrës për Anketën e Fuqisë Punëtore, si dhe për Anketën e Ekonomive Familjare Bujqësore;
- Nxjerrja e mostrave edhe për hulumtime të tjera shtesë, të cilat mund të kërkohen nga institucionet e ndryshme ndërkombëtare apo edhe ato vendore;
- Llogaritja e peshave për hulumtimet dhe anketat e lartcëkura;
- Rivlerësimi i peshave për hulumtimet e ndryshme statistikore;
- Llogaritja e gabimeve të mostrës për Anketën e Buxhetit dhe të Fuqisë Punëtore;
- Fillimi i realizimit të Projektit për Metadata;

- Përpilimi i planit për mbështetje në sektorin e Metodologjisë për vitin 2015-2017 nga SIDA suedeze.

4. FUSHAT E MBËSHTETURA NGA DONATORËT

- Ndhimja e donatorëve ka dhënë vazhdimisht ndikim në ngritjen e kapaciteteve të stafit dhe në përmirësimin e produkteve statistikore të ofruara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, për institucionet dhe përdoruesit e statistikave në tërësi.
- Në kuadër të mbështetjes nga donatorët, ASK-ja ka bashkëpunim të vazhdueshëm me EU, SIDA, FMN, UNFPA, UNICEF, UNDP.
- Ngritja e kapaciteteve dhe ndihma në fushën e projekteve do të jetë e vazhdueshme dhe me shumë interes për ASK-në. Gjatë vitit 2015, donatorët do ta mbështesin stafin në ngritjen e kapaciteteve në shumë aktivitete të ndryshme, me numër të konsiderueshëm pjesëmarrjeje në të gjithë sektorët e statistikave. Vazhdimi i mbështetjes së stafit të ASK-së për pjesëmarrje në takime, konferenca, trajnime, takime pune, grupe të punës, që janë të planifikuara në instrumentin planifikues të aktiviteteve, MC-listë, nga Eurostat-i për vitin 2015.
- Koordinimi i aktiviteteve në baza mujore, për takimet e stafit të ASK-së, realizimi i takimeve, aprovimet dhe raportet e aktivitetit, etj.
- Programi rajonal shumëpërfitues IPA 2012 MBP do të vazhdojë ta mbështesë ASK-në me 10 Pilot Projekte.
- Koordinimi dhe dokumentimi i proceseve, gjatë realizimit të Projektit të Binjakëzimit, në kuadër të zhvillimit të katër (4) komponentëve: 1. Një Sistem Cilësor për Statistikat, 2. Llogaritë Kombëtare, 3. Statistikat e Bisnesit, 4. Sistemi i Teknologjisë Informative.
- Koordinimi i aktiviteteve me departamentet në kuadër të dërgimit të të dhënave vjetore të Eurostatit për treguesit e shumtë statistikore. Dy runde brenda vitit “Mbledhja e të dhënave”.
- Koordinimi i aktiviteteve me departamentet në kuadër të mbledhjes dhe plotësimit të të dhënave për SMIS+.
- Organizimi i mbarëvajtjes së takimeve të Komitetit Drejtues të Projektit të Binjakëzimit dhe Komitetit Drejtues të SIDA-së.

- Rritja e bashkëpunimit të vazhdueshëm me donatorët dhe koordinimi i projekteve të mbështetura nga donatorët.
- Vlerësimi dhe koordinimi i vazhdueshëm për pilote-projektet (kontratat, faturat, pagesat, raportet, etj.).
- Bashkëpunimi me departamentet dhe realizimi në kohë i proceseve statistikore.
- Koordinimi i proceseve statistikore me vendet e BE-së dhe të rajonit, harmonizimi i tyre në kuadër të strategjisë 2014-2020.
- ASK-ja ka një mbështetje të lartë nga donatorë të ndryshëm në përmirësimin e proceseve të produkteve statistikore. Tabela me poshtë tregon emrin e projekteve në implementim, si dhe emrin e mbështetjes nga donatorët:

Projektet e mbështetura nga Donatorët, që janë në proces të zhvillimit	Donatorët:
Regjistrimi i Bujqësisë 2014-2015	DFID, SDC, Sida, Qeveria e Luksemburgut, Qeveria e Danimarkës, BE, dhe Qeveria e Kosovës
Zhvillimi i Statistikave në Agjencinë e Statistikave të Kosovës (ASK)	Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (Sida/SCB)
Mbështetja dhe ngritja e kapaciteteve afatgjata për ASK-në	UNICEF
Statistikat e Llogarive Kombëtare në Kosovë	FMN
IPA-2012- Mbështetje për Statistikat Kombëtare –Projekti i Binjakëzimit me Statistikat e Danimarkës	Zyra e BE-së
Anketa e Buxhetit Familjar, Komponentët e varfërisë	Banka Botërore
Zbatimi i i Anketës së Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë (AGTSh)	UNICEF

5. SFIDAT

Një ndër sfidat kryesore të ASK-së në vitin 2015 është mungesa e buxhetit dhe mungesa e stafit.

Po ashtu, sfidat e tjera me të cilat pritet të ballafaqohet ASK-ja janë:

- finalizimi i zbatimit të planit të Riorganizimit të ASK-së,
- zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare (PSZ),
- përmirësimin e vazhdueshëm të të dhënave statistikore,
- krijimin e një sistemi unik statistikor të TI-së,
- realizimin e Projektit të Regjistrimit të Bujqësisë,

- zbatimin e Kornizës së Vlerësimit të Performancës së PVSZ,
- kalimi në Nomenklaturën e Aktiviteteve Ekonomike, NACE Rev. 2,
- kuadri i burimit të të dhënave, ende i pamjaftueshëm dhe mungesa e burimeve njerëzore evidente,
- publikimi i rezultateve preliminare të Regjistrimit të Bujqësisë,
- harmonizimi i statistikave ndërmjet ASK-së dhe ministrive, që janë prodhuese të statistikave,
- fillimi i projektit IPA 2012 (MB) - Programi i bashkëpunimit statistikor me shumëpërfitues IPA 2012 dhe përgatitja adekuate për IPA 2.

6. SHPËRNDARJA E TË DHËNAVE & QASJA

- Vendosja e DevInfo databazës në ueb-faqen e ASK-së me të dhënat e Regjistrimit të Popullsisë 2011.
- Ofrimi i të dhënave statistikore në ueb-faqen e ASK-së në formatin Excel, për të gjitha departamentet statistikore.

Më poshtë është kalendari i publikimeve 2015

Kalendari i Publikimeve 2015		
janar		
13 janar 2015	Indeksi i Çmimeve të Konsumit	(Dhjetor 2014)
30 janar 2015	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Dhjetor 2014)
30 janar 2015	Buletini Tremujor	(TM4 - 2014)
shkurt		
05 shkurt 2015	Statistikat e Transportit	TM4/2014
05 shkurt 2015	Repertori stat. mbi ndër. Ekon. në Kosovë	TM4/2014
13 shkurt 2015	Indeksi i Çmimeve të Konsumit	(Janar 2015)
16 shkurt 2015	Indeksi i Çmim. të Prodh. dhe Çmim. në Bujqësi	TM4/ 2014
20 shkurt 2015	Indeksi i Çmim. të Inputeve dhe Çmim. në Bujqësi	TM4/2014
20 shkurt 2015	Statistikat e Mirëqenies Sociale	2014
24 shkurt 2015	Indeksi i Çmim. të Prodh. dhe Çmim. në bujqësi	2010-2014
25 shkurt 2015	BPV me Qasjen e Shpenzimevet dhe Prodhimit	TM2-2014
27 shkurt 2015	Indeksi i Çmim. të Inputeve dhe Çmim. në bujqësi	2010-2014
27 shkurt 2015	Statistikat e tregtisë së jashtme	(janar 2015)
mars		
10 mars 2015	Bilanci i Energjisë në Kosovë	TM4/2014
13 mars 2015	Indeksi i Çmimeve të Konsumit	(Shkurt 2014)

16 mars 2015	Statistikat e Hotelerisë	TM4/2014
16 mars 2015	Indeksi i Çmimeve të Importit	TM4/2014
18 mars 2015	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit	TM4/2014
19 mars 2015	Katalogu i Publikimeve të ASK-së	2014
20 mars 2015	Indeksi i Kosos së Ndërtimit	TM4/2014
27 mars 2015	Statistikat Afatshkurtra të Industrisë	TM4/2014
31 mars 2015	Statistikat e tregtisë së jashtme	(shkurt 2015)
prill		
10 prill 2015	Statistikat afatshkurtra te tregtise me pakicë	TM4/2014
10 prill 2015	BPV me Qasjen e Shpenzimevet dhe Prodhimit	TM3-2014
13 prill 2015	Indeksi i Çmimeve të Konsumit	(Mars 2015)
17 prill 2015	Disa Fakte mbi Mjedisin	2013-2014
30 prill 2015	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Mars 2014)
30 prill 2015	Buletini Tremujor	TM1/2015
maj		
05 maj 2015	Statistikat e Transportit	TM1/2015
06 maj 2015	Repertori stat. mbi ndër. Ekon. në Kosovë	TM1/2015
12 maj 2015	Statistikat e Mirëqenies Sociale	TM1/2015
13 maj 2015	Indeksi i Çmimeve të Konsumit	(Prill 2015)
15 maj 2015	Indeksi i Çmim. të Prodh. dhe Çmim. në Bujqësi	TM1/2015
19 maj 2015	Indeksi i Çmim. të Inputeve dhe Çmim. në Bujqësi	TM1 /2015
20 maj 2015	Anketa e Fuqisë Punëtore	2014
29 maj 2015	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Prill 2014)
29 maj 2015	Gratë dhe Burrat në Kosovë	2012/2013
qershor		
10 qershor 2015	Bilanci i Energjisë në Kosovë	TM1/2015
11 qershor 2015	BPV me Qasjen e Shpenzimevet dhe Prodhimit	TM4/2014
11 qershor 2015	Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare	2014
12 qershor 2015	Statistikat e Arsimit për çerdhe dhe parshkollor	2014-2015
12 qershor 2015	Vlerësimi i Popullsisë	2014
15 qershor 2015	Vjetari Statistikor	2015
15 qershor 2015	Indeksi i Çmimeve të Konsumit	(Maj 2015)
15 qershor 2015	Statistikat e Hotelerisë	TM1/2015
16 qershor 2015	Indeksi i Çmimeve të Importit	TM1/2015
17 qershor 2015	Llogaritë Qeveritare	2014
17 qershor 2015	Lindjet në Kosovë	2014
18 qershor 2015	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit	TM1/2015
19 qershor 2015	Indeksi i Kosotos së Ndërtimit	TM1/2015
19 qershor 2015	Indeksi i Çmimeve të Konsumit	2014
19 qershor 2015	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	2014

26 qershor 2015	Stat. e jurisprudencës për persona madhor	2014
29 qershor 2015	Statistikat Afatshkurtra të Industrisë	TM1/2015
30 qershor 2015	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Maj 2015)
korrik		
08 korrik 2015		2014-2015
08 korrik 2015	Statistikat afatshkurtra të tregtisë me pakicë	TM1/2015
13 korrik 2015	Indeksi i Çmimeve të Konsumit	(Qershor 2015)
16 korrik 2015	Vdekjet në Kosovë	2014
30 korrik 2015	Kurorëzimet në Kosovë	2014
30 korrik 2015	Shkurorëzimet në Kosovë	2014
31 korrik 2015	Buletini Tremujor	TM2/2015
31 korrik 2015	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Qershor 2015)
gusht		
05 gusht 2015	Statistikat e Transportit	TM2/2015
05 gusht 2015	Repertori stat. mbi ndër. Ekon. në Kosovë	TM2/2015
13 gusht 2015	Statistikat për arsimin e mesëm të lartë	2014-2015
13 gusht 2015	Indeksi i Çmimeve të Konsumit	(Korrik 2015)
17 gusht 2015	Indeksi i Çmim. të Prodh. dhe Çmim. në Bujqësi	TM2/2015
21 gusht 2015	Indeksi i Çmim. të Inputeve dhe Çmim. në Bujqësi	TM2/2015
21 gusht 2015	BPV në Qasjen e Shpenzimevet dhe prodhimit	TM1/2015
28 gusht 2015	Statistikat e Mirëqenies Sociale	TM2/2015
31 gusht 2015	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Korrik 2014)
shtator		
10 shtator 2015	Bilanci i Energjisë në Kosovë	TM2/2015
14 shtator 2015	Statistikat e Hotelerisë	TM2/2015
14 shtator 2015	Indeksi i Çmimeve të Konsumit	(Gusht 2015)
16 shtator 2015	Indeksi i Çmimeve të Importit	TM2/2015
17 shtator 2015	Statistikat e Varfërisë	
18 shtator 2015	Indeksi i Kostos së Ndërtimit	TM2/2015
18 shtator 2015	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit	TM2/2015
28 shtator 2015	Stat. e jurisprudencës për persona të mitur	2014
29 shtator 2015	Kosova në Shifra	2014
29 shtator 2015	Statistikat Afatshkurtra të Industrisë	TM2-2015
30 shtator 2015	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Gusht 2015)
30 shtator 2015	Statistikat afatshkurtra të tregtisë me pakicë	TM2 - 2015
tetor		
13 tetor 2015	Indeksi i Çmimeve të Konsumit	(Shtator 2015)
16 tetor 2015	Statistikat e Kulturës	2014
30 tetor 2015	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Shtator 2015)
30 tetor 2015	Buletini Tremujor	TM3 - 2015

nëntor

04 nëntor 2015	Statistikat e Shëndetësisë	2014
05 nëntor 2015	Statistikat e Transportit	TM3/2015
05 nëntor 2015	Repertori stat. mbi ndër. Ekon. në Kosovë	TM3/2015
10 nëntor 2015	Bruto Produkti Vendor (BPV) në Qasjen e Shpenzimeve	2014
10 nëntor 2015	Bruto Produkti Vendor (BPV) - Qasja e Prodhimit	2014
13 nëntor 2015	Indeksi i Çmimeve të Konsumit	(Tetor 2015)
17 nëntor 2015	Indeksi i Çmim. të Inputeve dhe Çmim. në Bujqësi	TM3/2015
18 nëntor 2015	BPV me Qasjen e Shpenzimevet dhe Prodhimit	TM2-2015
20 nëntor 2015	Statistikat e Arsimit	2014-2015
20 nëntor 2015	Indeksi i Çmim. të Inputeve dhe Çmim. në Bujqësi	TM3-2015
30 nëntor 2015	Statistikat e mirëqenies sociale	TM3-2015
30 nëntor 2015	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Tetor 2015)
30 nëntor 2015	Kalendari i Botimeve të ASK-së	2016

dhjetor

09 dhjetor 2015	Rezultatet e Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve	2014
10 dhjetor 2015	Bilanci i Energjisë në Kosovë	TM3/2015
14 dhjetor 2015	Indeksi i Çmimeve të Konsumit	(Nëntor 2015)
14 dhjetor 2015	Statistikat e Hotelarisë	TM3/2015
14 dhjetor 2015	Fletëpalosja e ASK-ës	2015
14 dhjetor 2015	Anketa e Mbeturinave Industriale	2014
16 dhjetor 2015	Indeksi i Çmimeve të Importit	TM3/2015
18 dhjetor 2015	Indeksi i Kostos së Ndërtimit	TM3/2015
18 dhjetor 2015	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit	TM3/2015
23 dhjetor 2015	Kalendari i ASK-ës	2016
28 dhjetor 2015	Anketa e Mbeturinave Komunale	2014
28 dhjetor 2015	Statistikat Afatshkurtra të Industrisë	TM3/2015
30 dhjetor 2015	Statistikat afatshkurtra të tregtisë me pakicë	TM3/2015
30 dhjetor 2015	Llogaritjet ekonomike në bujqësi	
30 dhjetor 2015	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Nëntor 2014)

7. BUXHETI

Për periudhën e përmendur të Hartës Rrugore 2015, buxheti për ASK të jetë si në vijim:

Buxheti për ASK 2015

Buxheti 2015	€
	MF *
Pagat	834,829
Mallrat dhe Shërbimet	320,450
Shpenzimet kapitale	
Shpenzimet kosto	31,875
TOTAL:	1,187,154
Numri i punëtorëve	139

*Shënim:

- Në kategorinë “Paga dhe Mëditje” janë kërkesat buxhetore të ASK-së për vitin 2015 me rritje.
- Në kategorinë “Mallra dhe Shërbime”, si dhe “Komunali” vazhdon të jetë në fuqi Vendimi i Qeverisë për zvogëlim të këtyre dy kategorive, në masë prej 15%.

Aneksi 1 - Organogrami i ASK-së

